



KONKURS PËR GAZETARË

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, përmes projektit “Fuqizimi i akterëve të shërbimeve sociale për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e cenueshme në Kosovë”, mbështetur nga UNICEF në Kosovë në partneritet me USAID dhe përmes programit të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’, bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut, ndan çmimet vjetore për tregimet më të mira në media në fushën e mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve në Kosovë, për vitin 2023.

Tre çmime vjetore në gazetari, në vlerë prej 500 Euro secila, do të ndahen për shkrimet apo reportazhet më të mira të botuara në portale, radio dhe televizione të ndryshme në Kosovë, gjatë vitit 2023.

Aplikantët që konkurrojnë duhet t'i përmbahen këtyre kritereve:

1. Të kenë shkrim, botim, dokumentar apo reportazh televiziv/radiofonik që trajton tema të cilat kanë të bëjnë me fëmijët dhe ndërlidhen me shërbimet dhe mbrojtjen e tyre në Kosovë, **të botuara nga data 15 Nëntor 2022 deri në datën 3 Nëntor 2023.**
2. Të dërgojnë punimin / shkrimin / publikimin e tyre **VETËM** në formë elektronike me e-mail, në këtë adresë: info@komfosova.org.
3. Të bashkëngjisin në emailin ku aplikojnë, dy dokumente si më poshtë:
 - Të dhënat e aplikantit (emër, mbiemër, mediumi ku punon, e-mail dhe numri i telefonit) së bashku me titullin e botimit, datën e saktë të publikimit të tij dhe vegëzën për qasje në artikull.
 - Punimin e plotë me të cilin aplikanti po konkuron.
4. Gazetarët kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se një botim / punim.

Afatet për aplikim:

- Konkursi do të qëndrojë i hapur që nga data e shpalljes së tij në www.portalpune.com dhe faqet zyrtare të KOMF, deri më **17 Nëntor 2023.**
- Çmimet për fituesit do të ndahen gjatë një ceremonie e cila do të organizohet në Dhjetor 2023.



Kriteret e vlerësimit të aplikimeve për çmimet vjetore:

Aplikimet e mbërritura në adresën zyrtare të KOMF do të kalojnë tre faza të vlerësimit; vlerësimin administrativ për të kontrolluar nëse dosja është e plotë, vlerësimin cilësor nga Komisioni i Pavarur i jashtëm për të përcaktuar fituesit dhe validimin e fituesve nga KOMF.

FAZA 1: Në fazën e vlerësimit administrativ të aplikimeve të mbërritura, do të shqyrtohen:

- 1 Aplikimi është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në thirrje.
- 2 Dosja e aplikimit është e plotë (sikurse ceket tek kriteret).
- 3 Aplikimi është dorëzuar me e-mail.

FAZA 2: Në fazën e vlerësimit cilësor nga Komisioni i Pavarur i jashtëm, do të shqyrtohen:

- 1 Rëndësia e shkrimit/botimit/artikullit.
- 2 Ndikimi në përmirësimin e pozitës së fëmijëve në shoqëri.
- 3 Struktura e shkrimit/botimit/artikullit dhe llojshmëria e burimeve.
- 4 Respektimi i parimeve etike dhe standardeve profesionale gjatë raportimit për fëmijë.

FAZA 3: Punimet e zgjedhura nga Komisioni i Pavarur i jashtëm do të nënshtrohen shqyrtimit dhe validimit si fitues nga paneli i KOMF, i cili do të vlerësojë:

- 1 Nëse ato janë në përputhje me të gjithë standardet.
- 2 Nëse ato janë në përputhje me të gjitha procedurat.
- 3 Nëse ato janë në përputhje me të gjithë parimet e mbrojtjes së fëmijëve.

KOMF inkurajon të gjithë gazetarët që kanë punuar shkrime apo reportazhe të të gjitha trajtave, të cilat trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, dhe të cilat synojnë dhënien e kontributit në përmirësimin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre, të aplikojnë për tre çmimet e mëdha që do të ndahen këtë vit.